SUBJEKTI
"W.CENTER" SHPK

NIPT K63029402A

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

INDUSTRIA KIMIKE

ID 4.7	MAGAZINIM I KIMIKATEVE, PËRVEÇ KUR PARAQITEN SI PJESË E NDONJË VEPRIMTARIE TJETËR TË TIPIT A OSE TIPIT B DHE PËRVEÇ NDODHJES NË NJË ÇISTERNË TË LËVIZSHME.
ID 4.9	PRODHIMI DHE PËRPUNIMI/PËRZIERJA E PRODUKTEVE TË PASTRIMIT/ DETERGJENTEVE.

Klasifikimi referuar Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 108-2024 "Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar")

VENDNDODHJA:

Tiranë, Rruga Butrinti, Tirane , Kashar 1051, ndodhur në pasurinë e paluajtshme të llojit ndërtesë, të rregjistruar në AKSH me numër pasurie 1186/28/ND, Zona Kadastrale 2105, 1051.

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1. PROFILI I OPERATORIT.....3

2. QËLLIMI I RAPORTIT.....3

3. OBJEKTIVAT E RAPORTIT.....3

4. VENDNDODHJA E AKTIVITETIT.....4

5. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT..... 6

6. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I SHKARKIMEVE DHE NDIKIMEVE NË MJEDIS.....9

7. MASAT ZBUTËSE DHE PARANDALUESE TË NDIKIMEVE NË MJEDIS.....14

8. MONITORIMI.....15

1. PROFILI I OPERATORIT

Subjekti **"W.CENTER"** është i regjistruar ne QKB me Formë Ligjore si **Shoqëri me përgjegjësi të Kufizuar (SHPK)**, i pajisur me Nr. Identifikimi **NIPT K63029402A**, me Administrator **Z. Bledar Shemaj.**

Fusha e veprimtarisë së operatorit konsiston në:
Import-Eksport,makineri industriale dhe ndertimi,paisje elektronike,automjete te reja dhe te perdorura,material bujqesore dhe ushqimore,fruta perime,pjese kembimi goma bateri.Punime druri dhe mobilje,duralumini metalike. Import-Eksport konfeksione, paisje hidrosanitare, hidraulike, elektrike, kancelari. Tregetim te disfektanteve e pesticideve dhe makineri mjekesore. Mirmbajtje ambjenteve te jashtme si gjelberim dhe pastrim i tyre. Import-eksport si dhe regti me shumice e pakice te pajisjeve mjeksore. Aktivitet ne fushen e tregetimit te materialeve te pastrimit. Tregtim mallra me shumice dhe pakice pajisje laboratori dhe aparatura laboratorike dhe mjeksore, kite reagent, materiale konsumi per laboratoret biokimike, fiziko kimik, biologjike si dhe per laboratoret e shkollave. Produkte kimikate per trajtimin e ujit te pijshem. Ne fushen e kurseve te formimit profesional per2 pastrime profesionale ne fushen e hotelerise, shtepi e rezidenca, zyra dhe institucione, qendra tregetare, pastrim dhe mirembajtje te ambjenteve te brendshme dhe te jashtme. Per sherbime lavanderie (larje rrobash) dhe sherbim rrobaqepsie (qepje rrobash).Magazinim dhe Tregtim të Produkteve Kimike, përfshirë Biocide dhe Pesticide

2. QËLLIMI I RAPORTIT

Subjekti paraqet këtë raport, sepse kërkon të aplikojë për leje mjedisi Tip B për aktivitetin:

INDUSTRIA KIMIKE

ID 4.7	**Magazinim i kimikateve, përveç kur paraqiten si pjesë e ndonjë veprimtarie tjetër të tipit A ose tipit B dhe përveç ndodhjes në një çisternë të lëvizshme.**
ID 4.9	**Prodhimi dhe përpunimi/përzierja e produkteve të pastrimit/ detergjenteve.**

Klasifikimi referuar Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 108-2024 "Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar")

3. OBJEKTIVAT E RAPORTIT

1. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis (Emetimet në ajër, Gjenerimi i zhurmave; Ndikimi në florë/faunë; Mbetjet e gjeneruara; Ndikimi social-ekonomik; Ndikimi në cilësinë e jetës në qendrat e banuara; Ndikim në peisazhin e zonës).
2. Gjetja e alternativave që janë me miqësore me mjedisin dhe propozimi i masave të duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale negative gjatë zbatimit të aktivitetit.
3. Lehtësimi i infomimit të publikut dhe organeve vendim-marrëse mjedisore, lidhur me zbatimin e aktivitetit.

4. VENDNDODHJA E AKTIVITETIT

Aktiviteti do të zhvillohet në adresën: **Tiranë, Rruga Butrinti, Tirane , Kashar 1051, ndodhur në pasurinë e paluajtshme të llojit ndërtesë, të rregjistruar në AKSH me numër pasurie 1186/28/ND, Zona Kadastrale 2105, 1051.**

Subjekti posedon kontrate qiraje me Nr. Repertori **3438**, Nr. Koleksioni **2541**, Datë **07.10.2024**, për sipërfaqen ku do të zhvillojë aktivitetin për të cilin kërkon të pajiset me leje mjedisore tipi B.

Qiradhënës: Perikli Lleshi dhe Albert Lleshi
Qiramarrës: Shoqëria "W.CENTER" SHPK.

Objekt i kontratës: Dhënia me qira e pasurisë të paluajtshme me të dhënat e mëposhtëme:

Lloji I pasurise	Ndërtesë
Siperfaqe që do jepet me qira	720 m^2
Adrese	Rr.
Zona Kadastrale	2105
Numer pasurie	1186/28-ND
Faqe	164
Volumi	29

Afati i kontratës: 3 vite (01.10.2024 – 01.10.2027)

Koordinatat e vendndodhjes së aktivitetit janë si më poshtë:

Nr.	X	Y
1.	4393769.23	4581318.19




W.CENTER SHPK
https://geoportal.asig.gov.al
Data e Printimit: 24.10.2025.
477013.087
4580622.399
477632.087
4580622.399
N
W.CENTER SHPK
Legjenda
RGB
2025
Ortofoto
Shtresë
Bazë
477013.087
4580229.699
477632.087
4580229.699
https://geoportal.asig.gov.al:ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse.
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.
0 25 50 100 m
Sistemi koordinativ: KRGJSH
Projektimi: KRGJSH


NJQV
https://geoportal.asig.gov.al
Data e Printimit: 24.10.2025.
465440.995
4586669.227
487600.356
4586669.227
ZALL HERR
VORË
BËRXULLË
KAMËZ
MAMINAS
W.CENTER SHPK
PASKUQAN
KASHAR
GJEPALAJ
VAQARR
N
Legjenda
NJësit e Qeverisjes Vendore
NJQV Census
NJQV Census
Ortofoto
Shtresë
Bazë
465440.995
4572590.630
487600.356
4572590.630
https://geoportal.asig.gov.al:ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse.
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.
0 1250 2500 5000 m
Sistemi koordinativ: KRGJSH
Projektimi: KRGJSH

5. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

ID 4.7	**Magazinim i kimikateve, përveç kur paraqiten si pjesë e ndonjë veprimtarie tjetër të tipit a ose tipit b dhe përveç ndodhjes në një çisternë të lëvizshme.**

Subjekti kryen magazinimin e produkteve per procesin e DDD (dezinfektim, dezinsektimi, deratizimit). Procesi i Punës për Magazinimin e Kimikateve DDD

1. Pranimi i kimikateve
   - Produktet kimike (dezinfektues, insekticide, rodenticide, etj.) pranohen nga furnitorët me faturë dhe dokumentacionin përkatës të sigurisë (fletët e të dhënave të sigurisë).
   - Kontrollohet gjendja e ambalazhit dhe etiketimi për të siguruar që nuk ka dëmtime ose rrjedhje.
2. Regjistrimi dhe etiketimi
   - Çdo produkt regjistrohet në regjistrin e magazinës me të dhëna si: emri tregtar, sasia, data e pranimit, afati i përdorimit dhe klasa e rrezikut.
   - Etiketat duhet të jenë të dukshme dhe të lexueshme sipas kërkesave të sigurisë.
3. Ruajtja dhe organizimi
   - Kimikatet ruhen në një ambient të veçantë dhe të ajrosur mirë, me temperaturë të kontrolluar dhe pa lagështi.
   - Substancat që janë të papajtueshme kimikisht ruhen të ndara (p.sh. oksiduesit, acidet dhe bazat).
   - Përdoren rafte metalike ose plastike rezistente, me tabele sinjalizuese për rrezikshmëri.
4. Dalja e kimikateve për përdorim
   - Produktet merren nga magazina sipas kërkesave ditore për proceset e DDD.
   - Regjistrohet çdo dalje dhe kontrollohet që sasia e mbetur të përputhet me evidencën.

MASAT E SIGURISË

- Në magazinë vendosen shenja paralajmëruese ("Rrezik – Kimikate", "Ndalimi i hyrjes pa leje").
- Mbahen pajisje emergjente: fikëse zjarri, absorbentë për derdhje dhe ventilim i mjaftueshëm.
- Punonjësit janë të trajnuar për përdorimin e sigurt të kimikateve dhe për menaxhimin e situatave emergjente.

MENAXHIMI I MBETJEVE

- Kimikatet e skaduara do të raportohen dhe asgjësohen në mënyrë të kontrolluar.

ID 4.9	Prodhimi dhe përpunimi/përzierja e produkteve të pastrimit/ detergjenteve.

Procesi i Punës për Prodhimin dhe Përzierjen e Produkteve të Pastrimit / Detergjenteve

1. Pranimi i lëndëve të para
   - Lëndët e para pranohen nga furnitorët me dokumentacionin përkatës të sigurisë.
   - Kontrollohet gjendja e ambalazhit dhe cilësia vizuale para se të futen në proces.

2. Magazinimi i lëndëve të para
   - Lëndët e para ruhen në ambiente të veçanta, të thata dhe të ventilueshme mirë, të ndara sipas tipit kimik dhe klasës së rrezikut.
   - Çdo përbërës etiketohet dhe regjistrohet me sasinë, datën e hyrjes dhe afatin e përdorimit.

3. Përgatitja e përzierjes
   - Sipas recetës teknologjike, përzihen përbërësit.
   - Fillimisht shtohet uji, pastaj përbërësit e tjerë sipas rendit të përcaktuar.
   - Procesi shoqërohet me përzierje mekanike.

4. Ambalazhimi i produktit përfundimtar
   - Produkti përfundimtar filtrohet dhe derdhet në enë plastike (shishe) me ndihmën e pompave ose linjave gjysmë automatike.
   - Vendosen etiketat me emrin e produktit, përbërjen, datën e prodhimit dhe masat e sigurisë.

5. Magazinimi i produktit të përfunduar
   - Produktet e ambalazhuara ruhen në një depo të thatë, të ajrosur mirë dhe të ndarë nga lëndët e para.
   - Regjistrohet çdo dalje për shitje ose shpërndarje.

MENAXHIMI I MBETJEVE

- Mbetjet e procesit (ambalazhe bosh, ujë larës, mbetje përzierjesh) mblidhen veçmas dhe dorëzohen për asgjësim përmes një subjekti të licencuar.

MASAT E SIGURISË DHE MJEDISIT

- Punonjësit përdorin pajisje personale mbrojtëse (doreza, syze, maska).
- Vendosen shenja paralajmëruese për rrezik kimik dhe ndalohet ngrënia/pirja në zonën e prodhimit.
- Mbahen fikëse zjarri dhe sistem ventilimi funksional.

5.1. Lëndët e para dhe ndihmëse

Lëndë të para	Lëndë ndihmëse
Produkte kimike	Ujë
-	Energji Elektrike

5.2. Menaxhimi i instalimit

Menaxhimi i instalimit bëhet nga një staf i kualifikuar dhe trajnuar për të operuar dhe për të ushtruar aktivitetin në fjalë.
Për zhvillimin e aktivitetit, operatori operon konform të gjithë rregullave teknike, tatimore, fiskale dhe atyre mjedisore.
Puna është organizuar në mënyrë të tillë që të funksionojë në formën e një organograme, e cila tregon mënyrën e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësitë e secilit punonjës. Kjo metodë është efektive për realizimin sa më efiçent dhe të suksesshëm të punës.
Pak a shumë hierarkia dhe rrjedha e autoritetit tregohet në këtë skemë të thjeshtë, ku çdo gjë varet drejtpërdrejtë nga Administratori i kompanisë.

ORGANOGRAMA



6. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I SHKARKIMEVE DHE NDIKIMEVE NË MJEDIS

RREZATIMI JONIZUES
Nga zhvillimi i aktivitetit nuk do të ketë rrezatime jonizuese, pasi vetë natyra e aktivitetit nuk shoqërohet me ndikime të tilla.
VIBRACIONE
Zhvillimi i aktivitetit nuk shoqërohet me vibracione, pasi asnjë pajisje që përdoret në funksion të aktivitetit nuk gjeneron vibrime.
NDIKIMET NË KLIMË
Gjatë zhvillimit të aktivitetit nuk priten ndryshime të dukshme klimaterike, si në drejtim të përmirësimit ashtu edhe në atë të përkeqësimit të saj. Nuk do ketë ndryshime në temperaturë, në drejtim të erës, në sasinë e reshjeve. Pra kryerja e këtij aktiviteti nuk ndikon aspak në kushtet klimaterike të kësaj zone.
NDIKIMET NË POPULLËSI
Aktiviteti do të zhvillohet brenda vijës së verdhë të zonës urbane të Mëzezit. Aktiviteti nuk pritet të ketë ndikime negative të dukshme në popullsinë e zonës përkatëse. Ky projekt konsiderohet si një mundësi e mirë publike, e cila mund të sjellë përfitime ekonomike dhe mundësi punësimi për komunitetin lokal. Nuk parashikohen ndikime negative të drejtpërdrejta apo të tërthorta në jetesën dhe mirëqenien e popullsisë që jeton në afërsi të subjektit, ashtu edhe në aktivitetin e bizneseve që ndodhen pranë. Subjekti do të respektojë të gjitha normat ligjore në fuqi lidhur me ndotjen akustike dhe emetimet në ajër, duke garantuar që operimi i aktivitetit të mos shkaktojë shqetësime për komunitetin përreth. Gjithashtu, realizimi i këtij projekti nuk do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në lëvizjen apo zhvendosjen e popullsisë në rajonin ku do të zbatohet projekti.

NDIKIMET NË AJËR

Gjatë zhvillimit të aktivitetit do të ketë gjenerim të pluhrave nga lëvizja e mjeteve të transportit që do të sjellin lëndën e parë në subjekt si dhe gjatë transportit të produktit final.

Vlen të theksohet se mjetet e transportit menjëherë sapo të mbërrijnë në subjekt do të fiken dhe do të qëndrojnë të fikura derisa të përfundojë procesi i shkarkimit të lëndës së parë/ngarkimit të produktit final. Prandaj shkarkimet do të jenë në intervale kohore shumë të shkurtra, duke mos përbërë ndonjë shqetësim për banorët qe jetojnë në afërsi të instalimit dhe duke mos patur ndikim sinjifikativ në ndotjen e ajrit.

Gjithashtu gjatë prodhimit të detergjenteve, mund të çlirohen në ajër grimca të imëta (pluhur), komponime organike të paqëndrueshme (VOC).

Për minimizimin e tyre, në objekt do të mendohet të instalohen sisteme ventilimi me filtra, kapëse lokale dhe sistem aspirimi për të kontrolluar dhe filtruar shkarkimet para lëshimit në atmosferë.

NDIKIMET NË UJËRA

*Zona ku ushtrohet aktiviteti shtrihet në **pellgun ujëmbledhës të basenit ISHËM**, por sipërfaqja ku ndodhet aktiviteti nuk ka kontakt të drejtpërdrejtë me burime ujore sipërfaqësore.*

Sipërfaqja ku do të ushtrojë aktivitetin subjekti është e pozicionuar në distanca relativisht të largëta nga burimet ujore. Referuar të dhënave nga Asig Geoportal distancat janë:

- ***206.06 m** nga **Liqeni i Kasharit***
- ***1.28**km nga **Lumi i Lanës.***



Gjatë zhvillimit të aktivitetit subjekti përdor ujin në procesin e prodhimit të detergjentëve/pastruesve. Por uji përdoret në bazë të recetave përkatëse, duke përdorur vetëm sasinë e përcaktuar në recetë. Prandaj, në asnjë rast nuk do të ketë shkarkime të ujërave në mjedis.

Gjithashtu ju informojmë se aktiviteti ushtrohet në një ambient të mbyllur që nuk ka kontakt me ujrat e shiut. Rrjedhimisht zhvillimi i tij nuk shoqërohet me shkarkime të ujërave të ndotura nga rënia nën kontakt e shiut me kimikatet e magazinuara.
Uji gjithashtu përdoret edhe për shërbimet higjieno-sanitare. Këto ujëra shkarkohen direkt në rrjetin e kanalizimeve të zonës dhe menaxhohen më pas nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime që mbulon zonën ku zhvillohet aktiviteti.

NDIKIMET NË TOKË

Rreziku për ndotje të tokës ekziston në rastet e rrjedhjeve të paqëllimshme gjatë magazinimit ose transportit të kimikateve.
Por në këtë rast, proceset e punës nuk ndikojnë në ndotje të mjedisit tokësor. Kjo për faktin se aktiviteti do të ushtrohet në godinë të mbyllur dhe e gjithë sipërfaqja ku do të ushtrohet aktiviteti është e shtruar me beton, pra gjasat që toka të kontaminohet janë të ulëta. Do të zbatohen masa parandaluese si platforma me izolim dhe mbajtëse të dyfishta për enët me substanca të rrezikshme.



NDIKIMET MBI FLORËN DHE FAUNËN

Zona në të cilën ushtrohet aktiviteti është zonë urbane, në të cilën nuk takohen elementë të spikatur të florës dhe faunës.

Përreth kësaj zone, hasim bimësi të ulet dhe barishte të ndryshme. Aspekti faunistik i lidhur ngushtë me mjedisin rrethues këtu paraqet një larmi biologjike të varfër.
Për sa më lart, vlerësohet se zhvillimi i këtij aktiviteti nuk paraqet asnjë ndikim negativ në florë apo faunë.



NDIKIMET E AKTIVITETIT TË ZHVILLIMIT MBI NDËRTIMET, TRASHËGIMINË ARKITEKTONIKE HISTORIKE DHE ZONAT E MBROJTURA

Aktiviteti që ushtron shoqëria zbatohet në një zonë në sipërfaqen e së cilës dhe në nëntokën e saj nuk ka ndërtime lidhur me trashegiminë arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra të tjera. Kjo tregon që zona është e lirë për të realizuar këtë aktivitet dhe që zhvillimi i aktivitetit nuk ndikon në këto zona si në përmirësim apo përkeqësimin e tyre.

Duke iu referuar ASIG Geoportal, vërehet një distancë e konsiderueshme e Zonave të Mbrojtura nga sipërfaqja ku do të ushtrohet aktiviteti, përkatësisht:

- **11.14 km** nga **Peizazhi i Mbrojtur Krastë-Verjon.**
- **15.26 km** nga **Parku Kombëtar Qafshtamë.**
- **12.29 km** nga **Parku Kombëtar Mali i Dajtit.**



NDIKIMET NGA ZHURMAT

Ushtrimi i këtij aktiviteti do të shoqërohet me gjenerim të zhurmave të mjetet e transportit, si dhe gjatë procesesit të prodhimit. Mjetet do të fiken menjëherë sapo të mbërrijnë në subjekt për të minimizuar gjenerimin e zhurmave, ndërsa pajisjet e prodhimit do të kotrollohet periodikisht, me qëllim mbajtjen nën kontroll të nivelit të zhurmave.
Subjekti do të respektojë vlerat e lejuara të zhurmave dhe do të funksionojë brenda fashës orare të përcaktuar në Udhëzimin e Përbashkët Nr.2, Datë 15.11.2023 "Për nivelin kufi të zhurmës për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive Ekonomike-Shoqërore".

MENAXHIMI I MBETJEVE

MBETJE JO TË RREZIKSHME URBANE - Nga zhvillimi i aktivitetit të punonjësve, do të gjenerohen mbetje urbane me kodin **20 01 01**; **20 01 02** dhe **20 03 01**. Këto mbetje do të vendosen në kontenierë (kosha) brenda territorit të aktivitetit, për t'u depozituar më pas në vendet e përbashkëta të përcaktuara nga Njësia e Qeverisjes Vendore. Kontenierët do të jenë me ngjyra, në mënyrë që mbetjet të ndahen që në burim, gjithashtu ato do të jenë të mbyllur, për të evituar përhapjen e aromave të pakëndëshme, sidomos në kohë me temperatura të larta dhe në kontakt me lagështirën.

MBETJE NGA AKTIVITETI I PRODHIMIT/MAGAZINIMIT - Mbetjet e gjeneruara nga proceset e punës, fillimisht vendosen në kontenierë të posatshëm, të ndara sipas kodeve. Kontenieret etiketohen dhe evidentohen dhe pa arritur kontenierët kapacitetin maksimal mbajtës, njoftohet subjekti i licensuar, i kontraktuar për tërheqjen e tyre nga ambientet ku ushtrohet aktiviteti. Pasi subjekti i licensuar i tërheq mbetjet nga ambjentet e zhvillimit të aktivitetit, ai është përgjegjës për menaxhimin, trajtimin ose asgjësimin përfundimtar të tyre.

NDIKIMET E AKTIVITETIT NË RRUGËT LOKALE DHE TRANSPORTIN

Pranë vendndodhjes së ushtrimit të aktiviteti kalon ***Rruga Butrinti.***

Gjatë zbatimit të aktivitetit nuk do ketë ndryshime të rrjetit të rrugëve lokale dhe transportit. Për rrjedhojë aktiviteti nuk do ndikoje absolutisht në rrugët lokale dhe transport, përkundrazi subjekti është angazhuar të mirembajë rrugët lokale të transportit me qëllim të mbarvajtjes së mirë të aktivitetit të tij.



7. MASAT ZBUTËSE DHE PARANDALUESE TË NDIKIMEVE NË MJEDIS

MJEDISI TOKËSOR
➢ Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave të përcaktuara. ➢ Zbatimi i kushteve teknike dhe standarteve. ➢ Menaxhimi sa më efektiv i mbetjeve, me qëllim mbrojtjen e mjedisit tokësor. ➢ Pastrimi i mjedisit ne rast të shkarkimeve aksidentale. ➢ Mirmbajtja dhe gjelberimi i siperfaqes ➢ Ndërtimi i depozitave të magazinimit mbi platforma të papërshkueshme nga lëngjet dhe me mbrojtje sekondare. ➢ Aplikimi i planit të menaxhimit të rrezikut në rast derdhjesh ose aksidentesh (gjithashtu dhe trajnime për stafin).
CILËSIA E AJRIT
➢ Larja dhe pastrimi i ambienteve të punës periodikisht. ➢ Instalimi i sistemeve të filtrimit në linjat e prodhimit dhe përzierjes për të reduktuar çlirimin e pluhurit dhe VOC-ve. ➢ Vendosja e ventilimit lokal në pikat kritike të shkarkimit të ajrit. ➢ Mirëmbajtje periodike e sistemeve të aspirimit për të siguruar efikasitet të vazhdueshëm. ➢ Matje periodike e cilësisë së ajrit në ambientet e punës dhe jashtë objekteve. ➢ Mbajtja fikur e mjeteve të transportit në momentin që do të mbërrijnë në subjekt. ➢ Përdorimi I maskave mbrojtese për aparatin respirativ nga ana e punonjësve.
MJEDISI UJOR
➢ Parandalimi i shkarkimeve me tipologji ndotëse në mjediset ujore. ➢ Përdorimi i detergjentëve ecofriendly për larjen e ambjenteve të punës.
MENAXHIMI I MBETJEVE
➢ Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit. ➢ Diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara. ➢ Transportimi periodik i mbetjeve jo të rrezikshme urbane në vendepozitimin më të afërt të caktuar nga Njësia Vendore. ➢ Magazinimi i mbetjeve në ambiente të kontrolluara dhe të miratuara, sipas kërkesave të Legjislacionit përkatës. ➢ Dorëzimi i mbetjeve për trajtim/asgjësim te operatorë të licencuar. ➢ Mbajtja e regjistrave për çdo mbetje të gjeneruar dhe raportimi periodik tek autoritetet mjedisore.
GJENERIMI I ZHURMAVE
➢ Operimi brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës. ➢ Respektimi I gjitha rregulloreve gjatë proçesit të punës. ➢ Kontroll periodik i makinerive dhe pajisjeve që përdoren në funksion të aktivitetit, me qëllim reduktimin e mundësisë së gjenerimit të zhurmave prej tyre.

➢ Lëvizje e ngadaltë dhe e kujdesshme e mjeteve të transportit në ambjentet e aktivitetit. ➢ Vendosja e tabelave për zbatimin e rregullores në ambjentet e aktivitetit në mënyrë rigoroze. ➢ Vendosja e paisjeve zhurmuese në zona të izoluara akustikisht. ➢ Izolimi akustik i makinerive dhe përdorimi i teknologjive me zhurmë të ulët. ➢ Kufizimi i orarit të punës për proceset që krijojnë zhurmë të lartë. ➢ Monitorim periodik i niveleve të zhurmës dhe krahasimi me kufijtë ligjorë të përcaktuar.
MASAT PËR EMERGJENCA MJEDISORE
➢ Hartimi dhe zbatimi i Planit të Emergjencës Mjedisore. ➢ Trajnimi periodik i stafit për menaxhimin e situatave të emergjencës dhe përdorimin e pajisjeve për ndërhyrje të shpejtë. ➢ Pajisja e objektit me sistem alarmi, detektorë rrjedhjesh dhe mjetet mbrojtëse personale.

8. MONITORIMI

QËLLIMI I MONITORIMIT MJEDISOR

Të sigurojë të dhëna, nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

OBJEKTIVAT E MONITORIMIT:

1. Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të instalimeve.
2. Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
3. Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet objekti ku do të ushtrohet aktiviteti dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
4. Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
5. Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
6. Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
7. Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.

PLANI I MONITORIMIT NË MJEDIS

Do të kryhet monitorimin çdo 6 muaj për parametrat mjedisorë nga Laboratorë të Akredituar dhe do t'i raportojmë ato pranë Agjensisë Kombëtare të Mjedisit. Gjithashtu do të mbajmë edhe kopjet në subjekt dhe do t'ia vendosim në dispozicion inspektimeve që mund të ketë.

Nr.	Elementi i monitorimit	Frekuenca	KUSH?
1.	Monitorim i cilësisë së ajrit	Çdo 6 muaj	Laborator i Akredituar
2.	Monitorim i cilësisë së ujërave	Çdo 6 muaj	Laborator i Akredituar
3.	Monitorim i zhurmave	Çdo 6 muaj	Laborator i Akredituar
4.	Sasia e mbetjeve të gjeneruara	Në varësi të punës	Operatori
5.	Sasia e mbetjeve të transferuara	Në varësi të punës	Operatori
6.	Monitorim I gjendjes teknike të pajisjeve operuese	Çdo 1 vit	Operatori ose Teknikë të posatshëm

"W.CENTER" SHPK

Administrator

Bledar Shemaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Sh. p. k. "W. CENTER" NIPT K63029402A TIRANE - ALBANIA